



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

PSH. nr. 330/26

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT**, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Vedat Poterqoi- Kryetar, Kimete Gashi - Anëtare si dhe Isa Hasani- Anëtare, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Ministria e Kultures RS dhe ÇJK, me numër 330/26, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE Nika Pro – Ing Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe të inxhinierisë për ndërtimin e Stadiumit të ri në Pejë, në përputhje me Kategorinë III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA, me nr: te prokurimit: 207-25-10662-5-1-1, iniciuar nga Ministria e Kultures RS dhe ÇJK, më: 05/05/2026, mori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET**, si e bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Kultures RS dhe ÇJK, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE Nika Pro – Ing Sh.p.k, me nr: unik 811052307 - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe të inxhinierisë për ndërtimin e Stadiumit të ri në Pejë, në përputhje me Kategorinë III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA, me nr: te prokurimit: 207-25-10662-5-1-1, iniciuar nga Ministria e Kultures RS dhe ÇJK dhe i njejtë diskualifikohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik për një periudhë prej gjashtë (6) muaj, nga data: 05.05.2026 deri me 04.11.2026.

## ARSYETIM

### Kërkesa e AK – MKRS dhe ÇJK:

1. Autoriteti kontraktues pretendon se OE Nika Pro – Ing Sh.p.k, si pjesëmarrës ne aktivitetin e prokurimit me titull: Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe të inxhinierisë për ndërtimin e Stadiumit të ri në Pejë, në përputhje me Kategorinë III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA, me nr: te prokurimit: 207-25-10662-5-1-1, ka vepruar ne kundërshtim me nenin 99 te LPP-se, duke arsyetuar se operatorit ekonomik Nika Pro – Ing Sh.p.k, ka nderhyr ne policën e sigurimit te ofertes.
2. Autoriteti kontraktues, me tutje ne kerkesen e tij, ka sqaruar se pas gjate vleresimit te ofertave kemi evidentuar dyshime serioze ne policen e sigurimit te dorezuar ne oferten e OE Nika Pro – Ing, e cila eshte e leshuar ne emer te OE Nika Pro - Ing.
3. Me tutje, AK-ja ka sqaruar se, kemi kerkuar sqarim me shkrim nga kompania Sigkos, lidhur me kete police te sigurimit dhe nga te njejtit kemi pranuar pergjigje se QR code i polices se sigurimit nuk skanohet dhe pas verifikimit ne sistem te polices se sigurimit me nr: 060010330101471 rezulton se kjo police eshte e modifikuar/falsifikuar dhe me tutje kompania Sigkos ka sqaruar se kjo police e sigurimit eshte valide per Ministrin e Mbrojtjes, pra nuk i ka te dhenat e njejta.

Mbi bazen e sqarimeve te dhena me larte, autoriteti kontraktues kerkon marrjen e masave eventuale sipas nenit 99.2 te LPP-se me pretendimin se OE Nika Pro – Ing Sh.p.k, ka nderhyr ne policen e sigurimit.

### Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me te pranuar kërkesën e datës: 27.02.2026, te AK - Ministria e Kultures RS dhe ÇJK, e ka njoftuar OE Nika Pro – Ing Sh.p.k, me qellim qe operatori ekonomik ne fjale te jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE Nika Pro – Ing Sh.p.k, nuk i eshte pergjigjur kerkeses se OSHP-se per te dhene faktet dhe argumentet e veta, lidhur me pretendimin e AK-MKRS-se.

*Vlerësimi i pretendimeve të autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj OE Nika Pro – Ing Sh.p.k:*

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave paneli shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues – Ministria e Kultures RS dhe ÇJK, ka dorëzuar prova që dëshmon se Nika Pro – Ing Sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me nenin 99 të LPP-se.

Paneli shqyrtues, sqaron se faktin se autoriteti kontraktues në kërkesën e datës: 27.02.2026, ka bashkangjitur si provë email/konfirmimin e kompanisë së sigurimeve Sigkos, të cilët kanë deklaruar se: *“polica e sigurimit është e modifikuar/falsifikuar pa dijeninë e kompanisë tonë”*.

Për marrjen e masave ndaj operatorëve ekonomik Organi Shqyrtues i Prokurimit mund vepron vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, ka dorëzuar prova se OE Nika Pro – Ing Sh.p.k, ka vepruar në kundërshtim me nenin 99 të LPP-se, duke ndërhyrë në policën e sigurimit, ndërhyrje të cilën e ka konfirmuar me datën: 11.02.2026 kompania e sigurimeve Sigkos.

Andaj, paneli shqyrtues vlerëson se OE Nika Pro – Ing Sh.p.k duhet, **të diskualifikohet në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, nga pjesëmarrja në prokurim publik, për të gjitha procedurat e prokurimit, ashtu si është e përcaktuar me nenin 67.9, Rregullorja për Prokurim Publik Nr. 002/2024, si në vijim**” *Në rast se OSHP nxjerr një vendim për diskualifikim të një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në prokurimin publik prej datës së vendimit. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, “Pjesëmarrja në prokurim publik” është një proces që përfshin tërë ciklin nga njoftimi, aplikimi, përfshirë edhe çfarëdo kundërshtimi apo ankese, deri të vendimi për dhënie të kontratës, rrjedhimisht pamundëson çfarëdo veprimi që Operatori Ekonomik mund të ndërmerr përgjatë tërë procesit të prokurimit prej fazës së publikimit të njoftimit për kontratë deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, përfshirë edhe parashtrimin e ankesave. Ky përjashtim vlen për të gjitha llojet e kontratave dhe për të gjitha procedurat e prokurimit”*.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – MKRS

1x1 OE Nika Pro – Ing Sh.p.k

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

